



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-020
Prishtinë, më 27 shkurt 2018, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S Ë K R Y E S I S Ë S Ë K U V E N D I T, E M B A J T U R M Ë 2 7 S H K U R T 2 0 1 8

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Aida Dërguti, Kujtim Shala dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi dhe Bilall Sherifi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe shtatë (7) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme,
2. Përgatitjet për seancë plenare,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 5, 16 dhe 21 shkurt 2018.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

1. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8 dhe 9 shkurt 2018

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8 dhe 9 shkurt 2018, si dhe interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari, të mbahet të enjten, më 1 mars 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04/20 të datës 20. 12. 2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24 të datës 12 janar 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga Buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale,

2. *Debat parlamentar sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës,*
3. *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë,*
4. *Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016,*
5. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari.*

II. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Lidhur me përgatitjet për seancën plenare dhe rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Shqyrtimin në parim të Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, diskutuan: Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli; Xhavit Haliti, Aida Dërguti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Shqyrtimin në parim të Projekt-Rregullores së Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, që në afatin prej dhjetë (10) ditëve ta thërrasë një takim të përbashkët të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare për të diskutuar lidhur me Projekt-Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për harmonizimin e qëndrimeve, para procedimit për shqyrtim të parë në seancë plenare.
2. Grupet parlamentare në takimin e përbashkët që do të diskutohet për Projekt-Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës mund të marrin ekspertë të fushës përkatëse.

Në vazhdim, me propozim të nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti, Kryesia e Kuvendit e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës edhe Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

Pas diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës së Kuvendit të mbahet të premten, më 2 mars 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, ADA,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA),
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte të ndërtimit,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet postare,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologji,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare
20. Përzgjedhja e një (1) kandidati për pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
21. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
22. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
23. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa,
24. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22. 12. 2017 në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë,

25. *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës,*
26. *Debat parlamentar sipas kërkesës të nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe pesë (5) deputetëve nënshkrues për debat parlamentar lidhur me takimin IV të përbashkët të Komisionit Parlamentar të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, BE-Kosovë, i mbajtur më 17-19 janar 2018, në Strasburg (Francë),*
27. *Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare,*
28. *Formimi i Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Medieve.*

* * *

Gjithashtu, Kryesia lidhur me pikën 28 të lartcekur të rendit të ditës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 2 mars 2018, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Medieve.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë si në vijim: GP i LVV-së (kryetarin dhe 2 anëtarë), GP i LDK-së (2 anëtarë), GP i PDK-së (2 anëtarë), GP i AAK-së (zëvendëskryetarin e parë), GP i Listës serbe (zëvendëskryetarin e dytë), GP i “Nisma për Kosovën” (1 anëtar) dhe GP “6+” (1 anëtar).

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Propozim-Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2018

Kryesia, vendosi që Propozim-Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2018 të radhitet në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

2. Nisma legislative e Projektligjit për Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, hartuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

3. Shqyrtimi i propozimit të deputetëve, Mimoza Kusari dhe Dardan Sejdiu, të mbështetur edhe nga 13 deputetë tjerë nënshkrues, për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që deri në mbledhjen e radhës të Kryesisë t’i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar sipas propozimit së deputetëve Mimoza Kusari-Lila dhe Dardan Sejdiu, të mbështetur edhe nga 13 deputetë tjerë nënshkrues për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

2. Përbërja e komisionit do të jetë me 11 anëtarë: GP i LVV-së, 3 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i Listës serbe, 1 anëtar; GP i “Nisma për Kosovën”, 1 anëtar dhe GP “6+”, 1 anëtar.

3. Kryesuesi zgjidhet nga radhët e njërit grup parlamentar, i cili nuk është iniciator i Komisionit Hetimor dhe nuk i përket partisë së koalicionit qeverisës, ndërsa zëvendës/kryesuesi emërohet nga radhët e grupit të deputetëve iniciues.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë për caktimin e Dhomës së Sigurisë në hapësirën e Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë për caktimin e Dhomës së Sigurisë në hapësirën e Kuvendit.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e organizimit të Konferencës Rajonale dhe

mbulimin e shpenzimeve, e cila është paraparë të mbahet në Prishtinë, prej 12-13 mars 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E D N I M

Miratohet kërkesa e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbajtjen e Konferencës Rajonale, me temë “Pozita e femrës në shoqëri - të arriturat dhe sfidat”, si dhe mbulimi i shpenzimeve për realizimin e kësaj konference, e cila është planifikuar të mbahet në Prishtinë, më 12 -13 mars 2018.

6. Shqyrtimi i kërkesës së z. Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar, konstatoi që këtë çështje Administrata e Kuvendit ta diskutojë me kryetarin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, z. Ismajl Kurteshi, përkatësisht çështjen e renovimit të Sallës 506 në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

7. Raporti i delegacionit të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen e tij në punimet e Sesionit Itë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të mbajtur në Strasburg (Francë)

Kryesia u njoftua me shkrim nga delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës lidhur me pjesëmarrjen e tij në punimet e Sesionit I të kësaj asambleje, të mbajtur në Strasburg (Francë), nga 22-26 janar 2018.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Slavko Simiq, për lejimin e pagesës së faturës lidhur me një drekë zyrtare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Slavko Simiq, për mbulimin e shpenzimeve lidhur me drekën zyrtare të shtruar për një delegacion të huaj në “Swiss Diamond Hotel Prishtina”, në shumën prej 181,20€, sipas faturës së bashkangjitur me nr.11174837, datë 11. 12. 2017.

2. Kërkesa e deputetëve Blerta Deliu-Kodra dhe Armend Zemaj për kompensimin nga një (1) mëditje lidhur me udhëtimin zyrtar, të realizuar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e deputetëve Blerta Deliu-Kodra dhe Armend Zemaj për kompensimin e mëditjes për datën 10 shkurt 2018, lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në SHBA.

3. Kërkesa e deputetit Slobodan Petroviq për kompensimin e dy (2) mëditjeve lidhur me udhëtimin zyrtar, të realizuar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e deputetit Slobodan Petroviq për kompensimin e dy (2) mëditjeve, për datat 3 dhe 10 shkurt 2018, lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në SHBA.

4. Kërkesa për aprovimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vitin 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Anëtarëve të Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje sipas aprovimit nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, më 27.12.2017, u lejohej pjesëmarrja në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës sipas kalendarit të takimeve për vitin 2018, të bashkangjitur.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (me tejkalim të shpenzimeve në bazë të rezervimeve paraprake), për dreka/darka eventuale të shtruara gjatë takimeve me delegacionet e ndryshme të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, si dhe mëditjet për anëtarët e Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, sipas kërkesës nr. 06/776/Do-471, më 27.02.2018.

5. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes së Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në punimet/takimet e Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (AP PEJL-SEECP)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

I. Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore i lejohet udhëtimi zyrtar, sipas kërkesës për realizimin e udhëtimeve, si në vijim:

1. Mbledhja e Komisionit për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim për Sigurinë, e cila do të mbahet prej 2-4 mars 2018, në Sarajevë (Bosnjë-Hercegovinë).
2. Mbledhja e Komisionit të Përgjithshëm për Ekonomi, Infrastrukturë dhe Energji, e cila do të mbahet prej 9-11 mars 2018, në Stamboll (Turqi).
3. Mbledhja e Komisionit të Përhershëm Qendror, e cila do të mbahet prej 16-18 mars 2018, në Bled (Slloveni).
4. Seanca plenare e Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (PBEJL/SEECP), e cila do të mbahet prej 12-15 prill 2018, në Lubjanë (Slloveni).
5. Në mbështetje të delegacionit të Kuvendit të Kosovës gjatë pjesëmarrjes në të gjitha punimet/takimet e Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (PBEJL/SEECP) do të marrin pjesë edhe zyrtarët: Shaban Selimi dhe Bukuriye Rukolli nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

II. Shpenzimet lidhur me realizimin e udhëtimeve zyrtare të lartshënuara në pikën (I) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës nr. 06/789/Do-479, dt. 27.02.2018, të bashkangjitur.

Shënim: Kryetari konstatoi se të gjitha vendimet e lejuara për udhëtime jashtë vendit anulohen nëse Kuvendi mban seancë plenare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale